



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2023:132876

Datë: 26.12.2023

Numri i dokumentit: 05122594

PPP.nr.295/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Freskim Musliu, në çështjen përbarimore të kreditorit S . K . të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av. L . V . nga Prishtina, ndaj debitorit Komuna e Fushë Kosovës, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të datës 26.05.2023, të paraqitur kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.458/23, të Përbaruesit Privat I . K . nga Prishtina, jashtë seance, me datë 26.12.2023 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. HEDHET POSHTË si i pa afatshëm prapësimi i datës 26.05.2023, i parashtruar nga debitori Komuna e Fushë Kosovës, i paraqitur kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.458/23, të Përbaruesit Privat I . K . nga Prishtina dhe i njëjti urdhër mbetet në fuqi.
- II. Obligohet debitori Komuna e Fushë Kosovës, që kreditorit S . K . t'ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 117 eurove, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimi të këtij aktvendimi.

A r s y e t i m i

Përbaruesi Privat ka lëshuar Urdhrin Përbarimor P.nr.458/23, kundër debitorit Komuna e Fushë Kosovës, lidhur me përbarimin në bazë të dokumentit të dokumentit përbarimor – marrëveshjes së ndërmjetësimi, për shumën prej 60 eurove.

Ndaj urdhrit të lartcekur ka paraqitur prapësim debitori, me datë 26.05.2023, duke e kundërshtuar në tërësi propozimin për përbarim dhe urdhrin për përbarim, dhe duke kërkuar nga gjykata që ta aprovon prapësimin e debitorit dhe ta refuzon si të pabazuar urdhrin përbarimor.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, me anë të së cilës i ka kundërshtuar pretendimet e debitorit, sepse sipas kreditorit pretendimet e debitorit në prapësim nuk qëndrojnë.

I ka kërkuar shpenzimet e procedurës në emër të përgjigjes në prapësim në shumë prej 234 eurove.

Gjykata, pas analizimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se prapësimi i debitorit është paraqitur pas afatit të përcaktuar ligjor, për shkak se sipas fletëkthesës që gjendet në shkresat e lëndës vërtetohet se debitori urdhrin përmbarimor e ka pranuar me datë 18.05.2023, ndërsa prapësimin e ka paraqitur me datë 26.05.2023 (vula e pranimit të përmbaruesit në fund të prapësimi), pra në ditën e tetë.

Gjykata vlerëson se për këto prezumime procedurale kujdeset sipas detyrës zyrtare në çdo fazë të procedurës, prandaj, nga të cekurat më lart, duke u bazuar në nenin 73, par. 3 të LPP-së “*Me vendim prapësimi mund të pranohet, refuzohet ose hidhet poshtë si i pa afatshëm, si jo komplet dhe i palejuar*”, lidhur me nenin 70 të LPP-së “*Prapësimi duhet t’i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbarues ose urdhrin përmbarues*” vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi dhe nuk e shqyrtoi çështjen më tutje në mënyrë meritore.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, që debitori t’i bartë shpenzimet e procedurës për vendosje sipas prapësimi dhe atë duke u bazuar në nenin 452 të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së. Lartësia e shpenzimeve të procedurës të aprovuara në shumën prej 117 euro, i referohet shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim, duke u bazuar në Tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës. Gjykata e aprovoi këtë shumë, pra 117 euro, dhe jo dyfishin e kësaj shume, pra prej 234, të kërkuar nga kreditori në përgjigje në prapësim, për faktin se përgjigja në prapësim nuk konsiderohet mjet juridik për të cilin kërkohet dyfishi i shumës së paraparë për parashtresën për fillimin e procedurës, por përgjigja në prapësim konsiderohet parashtrësë, për të cilën sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, për shumën me këtë objekt kontesti, parashihet vlera prej 117 eurove.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
PPP.nr.295/23, datë 26.12.2023

Gjyqtari,
Freskim Musliu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, brenda 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa eventuale dorëzohet përmes kësaj gjykate.